



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.1090/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, në raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale të mbajtura më 19.11.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.11.2017, mori këtë:

### **V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS) me shenjen ZL.Anr.1090/2017 të datës 19.11.2017 e parashtruar kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, dega në Prizren, me të cilën ka kërkuar që t'ju shqiptohet dënimi me gjobë, për shkak të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore, në raundin e dytë për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me 19.11.2017.

### **A r s y e t i m**

PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.1090/2017 me datë 19.11.2017 nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ku ka pretenduar se me datë 18.11.2017 kryetari i subjektit politik NISMA, në Prizren, Zafir Berisha, në ditën e heshtjes zgjedhore, përmes rrjetit social Facebook ka bërë thirrje për ta votuar kandidatin e Lëvizjes Vetëvendosjes, me nr.10. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është shkelur neni 36 par.1 pika b) e LZP.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 21.11.2017, subjekti politik LVV thekson se pretendimet e BIRN janë të pa baza për arsye se LVV ka lidhur koalicion në nivel lokal për raundin e dytë të zgjedhjeve për Kryetar të Komunës së Prizrenit me subjektin politik NISMA, andaj LVV konsideron se marrëveshjet politike ndërmjet subjekteve politike, konkretisht ndërmjet LVV dhe NISMA, nuk ka asnjë efekt juridik mbi bazën e të cilës do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik LVV, për shkak të publikimit të një foto me një shkrim të caktuar nga anëtar i subjektit politik NISMA pa autorizimin e subjektit politik LVV. Më tej thekson se

legjislacioni në fuqi nuk i njeh koalicionet politike mbi të cilën do të mund ti shqiptohet gjobë subjektit tjetër politik. Më tej ka kërkuar që ankesa e ankuesit të Refuzohet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës BIRN dhe Internews Kosova, lidhur me shkeljen e pretenduar të Thyerjes së Heshtjes Zgjedhore nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga fotografia që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se kush e ka shpërndarë këtë postim.

Nga arsyet e theksuar më lartë dhe duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.Anr.1090/2017 më datën 21.11.2017.

**Kryesues i Panelit**  
**Hasan Shala**



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi